

**RELACION SHPJEGUES
PËR
PROJEKTVENDIMIN
“MBI PËRCAKTIMIN E TARIFËS PËR TË DREJTËN E KALIMIT
PËR RRJETET E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE TË
RREGULLAVE PËR MËNYRËN DHE AFATIN E PAGIMIT”**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN
TË ARRIHEN**

Projektakti vjen si propozim i Ministrit për Infrastrukturën dhe Energjinë, në zbatim të pikës 3, të nenit 35, të Ligjit Nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë dhe sigurimin e të drejtës së kalimit” dhe synon plotësimin e kuadrit të nevojshëm nënligjor të këtij ligji. Ky projektakt ka për qëllim të miratojë tarifën për të drejtën e kalimit për rrjetet e komunikimeve elektronike dhe rregullat për mënyrën dhe afatin e pagimit.

**II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN
POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN
ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA
POLITIKE**

Projektakti vjen si nevojë e plotësimit të kuadrit nënligjor në zbatim të ligjit Nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë dhe sigurimin e të drejtës së kalimit”.

**III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME
PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Ligji Nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë dhe sigurimin e të drejtës së kalimit”, në pikën 3, të nenit 35 “Tarifat e zbatueshme”, ka parashikuar përcaktimin e masës së tarifës për njësi të sipërfaqes, rregullat për mënyrën dhe afatin e pagimit si dhe përcaktimet mbi masën e tarifës së vitit të parë në kohën e fitimit të së drejtës së kalimit.

**IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE
HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E
NDËRKOMBËTAR**

Projektakti është hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës si dhe të pikës 3 të nenit 35 të ligjit Nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë dhe sigurimin e të drejtës së kalimit”.

Relacion shpjegues për Projektvendimin “Mbi përcaktimin e tarifës për të drejtën e kalimit për rrjetet e komunikimeve elektronike dhe të rregullave për mënyrën dhe afatin e pagimit”

Aktualisht tarifa për përdorimin, zënien e rrugës me qëllim instalimin e rrjeteve të telekomunikacionit është zbatuar nga enti pronar i rrugës bazuar në nenin 27 të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu bazuar në legjislacionin në fuqi për taksat vendore në Aneksin 6, ka përcaktime për rastin e zënies, përdorimit të pronës publike sipas bashkive të ndara në tre zona.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projekt akti nuk transponon ndonjë akt të veçantë të acquis së BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projekt akti është i organizuar në 7 pika dhe një shtojcë ku përcaktohen tarifa për të drejtën e kalimit për rrjetet e komunikimeve elektronike duke marrë parasysh rregullimet e zbatuara për këtë qëllim sipas Kodit Rrugor nga ARRSH si dhe duke referuar rregullimet në ligjin nr. 9920 datë 19.5.2008 të ndryshuar.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij projektakti janë organet e qeverisjes qendrore dhe ato vendore, përfaqësuese të pronës ku kërkohet ndërtimi i rrjetit të komunikimeve elektronike.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektakti është hartuar nga një grup pune me ekspertë nga MIE, AKEP dhe ARRSH dhe është mbështetur në praktikat e mira të vendeve tjera të rajonit.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektakti ruan rregullimet që ekzistojnë aktualisht, për pasojë nuk ka ndikim shtesë në të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të shtetit.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
DHE
MINISTËR
BELINDA BALLUKU**

Relacion shpjegues për Projektvendimin "Mbi përcaktimin e tarifës për të drejtën e kalimit për rrjetet e komunikimeve elektronike dhe të rregullave për mënyrën dhe afatin e pagimit"